



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2824/11 prot.

Datë 20.11.2025

V E N D I M
Nr. 1729/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1562/2025, datë 30.10.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** Operatori ekonomik “AMEL-E.Z” SHPK me NIPT L71421032N dhe adresë: Lagjja Mezez, rruga Sokrat Miho , zona e Astirit, godine 9 - kateshe, ap 6/6, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë)
- Subjekte të interesuara:** Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me adresë: NIPT M11313029O dhe me adresë: Rr. “Ndre Mjeda” Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njesi sherbimi nr. 1017, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1562/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Amel-E.Z” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma,veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Amel –E.Z” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Amel-E.Z” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2813/9 prot., datë 14.11.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatimin e vendimit” protokolluar me tonën nr. 2824/8 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1562/2025 datë 30.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 13.11.2025 për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.2813/9 prot., datë 14.11.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatimin e vendimit” protokolluar me tonën nr. 2824/8 prot., datë 18.11.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1562/2025 datë 30.10.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe

procesverbalin e datës 13.11.2025 për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën e prokurimit.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik “Amel-E.Z” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr. 1562/2025 datë 30.10.2025.

II.3. Sa më lart, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ dhe raportit të auditit në SPE rezulton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 1562/2025 datë 30.10.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-61685-09-17-2025, me objekt “Blerje uniforma, veshmbathje dhe element përbërës të tyre” për Drejtorinë e Përgjithshme Detare”, Tiranë”, me fond limit: 2,200,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 29.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

